

LIGJ NR. 7867, DATË 12.10.1994

**PËR MBROJTJEN E PASURISË KULTURORE
TË LUAJTSHME DHE TË PALUAJTSHME**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit 7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozim të Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Pasuritë kulturore të luajtshme e të paluajtshme që ekzistojnë dhe zbulohen në tokat private e shtetërore, në lumenj, liqene e në shelfin kontinental mbrohen nga shteti.

Trajtimi dhe ruajtja e pasurive kulturore bëhet nga shteti, dhe kur është e nevojshme në bashkëpunim me persona juridikë a fizikë.

Neni 2

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është ngarkuar për konservimin e pasurive kulturore dhe ndihmon për mirëmbajtjen e ruajtjen e tipareve të veçanta, njohjen dhe studimin e tyre.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe institucionet shkencore, bën regjistrimin e pasurive kulturore pronë e çdo personi juridik e fizik.

Çdo person juridik a fizik është i detyruar të ruajë tërësinë e vlerave kulturore e historike dhe i shfrytëzon sipas akteve të lidhura me institucionet përgjegjëse.

Neni 3

Pronari i tokës nuk ka të drejtë të shesë e zhvendosë pasuritë kulturore që gjenden në sipërfaqen e tokës së tij. Ai nuk ka të drejtë të kryejë punime për zbulimin e pasurive kulturore të tokës së tij, qoftë kjo tokë bujqësore a truall në qytet ose në fshat.

Neni 4

Është i ndaluar dëmtimi, transportimi ose zhvendosja dhe ndryshimi i karakteristikave të pasurive kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme. Ndalohet të vendosen pllakate dhe reklama në zonat arkeologjike dhe monumentet e kulturës të regjistruara e që janë nën mbrojtjen shtetërore, pa autorizimin e Institutit të Monumenteve të Kulturës.

Asnjë ndërtim i ri nuk mund të kryhet mbi rrënojat e pasurive kulturore të paluajtshme, asnjë hapje nuk mund të bëhet në godinat historike dhe muret rrethuese dhe as ndinjë ndërhyrje tjetër që prek tërësinë e tyre. Asnjë material ndërtimi, pjesë ose fragmente ndërtimore nuk mund të merren nga zonat arkeologjike e historike .

Neni 5

Ndalohet përdorimi i dedektorëve metalikë në zonat arkeologjike dhe monumentet e kulturës, pa autorizimin e institucioneve përkatëse.

KREU II

PASURI KULTURORE TË LUAJTSHME

Neni 6

Pasuri kulturore të luajtshme konsiderohen objektet të cilat nga natyra e tyre nuk janë bërë për të qenë të lidhura me terrenin ose objektin dhe mund të zhvendosen pa u dëmtuar.

Pasuritë kulturore të luajtshme ruhen në muzetë kombëtarë, muzetë e tjerë lokalë, institucionet shkencore, bibliotekat arkivat dhe institucionet e tjera shtetërore ose private, për qëllime studimi, restaurimi dhe ekspozimi.

Neni 7

Personave juridikë vendas mund t'u jepen për një periudhë të përcaktuar për qëllime restaurimi dhe mbrojtjen, pasuri kulturore të luajtshme, sipas kriterëve të caktuara për to me akte të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

Çdo person juridik a fizik që zotëron një pasuri kulturore të luajtshme, brenda 1 viti nga data e daljes së këtij ligji, duhet ta deklarojë atë pranë organeve të kulturës në pushtetin lokal ose institucionet e specializuara (Arkivi Qendror, Instituti Arkeologjik, Biblioteka Qendrore). Kur personat e mësipërm shkelin këtë afat, ata gjobiten sipas sanksioneve të parashikuara në këtë ligj.

Neni 9

Çdo person juridik a fizik që ka në pronësi një objekt të regjistruar si pasuri kulturore të luajtshme është i detyruar të krijojë kushte të mira për mirëmbajtjen e tij. Ai ka të drejtë ta shesë atë brenda vendit, sipas autorizimit të lëshuar nga komisionet e ngritura me miratimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 10

Çdo person juridik a fizik që zbulon ose gjen në çfarëdo mënyre një objekt kulturor, brenda dy javëve nga data e këtij zbulimi ose gjetjeje, të njoftojë organet e kulturës në pushtetin lokal ose

institucionet e specializuara, duke deklaruar mënyrën e gjetjes së objekteve kulturore dhe vendin ku është gjetur.

Pas deklarimit të objektit, komisionet e ngritura për këtë qëllim përcaktojnë nëse gjetësi mund ta mbaë atë vetë apo objekti të kalojë në mbrojtje të shtetit. Mënyrat dhe procedurat e vlerësimit të objektit kulturor përcaktohen me akte të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Pasuritë kulturore nuk dhurohen ose shkëmbehen ndërmjet institucioneve analoge me shtetet e tjera, me përjashtim të rasteve të veçanta, kur i shërbejnë interesave kombëtare që përcaktohen me akte të Këshillit të Ministrave .

Pasuritë kulturore unike nuk dhurohen ose shkëmbehen në asnjë rast.

Neni 12

Kriteret për importin dhe eksportin e pasurive kulturore dhe kalimi i tyre tranzit përcaktohen me marrëveshje dypalëshe, sipas konventës ndërkombëtare, “Për masat, ndakimet dhe parandalimet e importit të paligjshëm, eksportit dhe transferimit të pasurive kulturore” (14.11.1970) si dhe konventave të tjera ndërkombëtare.

Kur vërtetohet se një objekt është pasuri kulturore e vendit tonë që ndodhet në një vend tjetër dhe anasjelltas, importimiose eksportimi bëhet vetëm pas kërkesës zyrtare dhe dokumenteve juridike e shkencore të paraqitura nga pala kërkuese, si dhe sipas kriterëve të përcaktuara me akte të Këshillit të Ministrave.

Kur një objekt i pasurisë kulturore eksportohet në mënyrë të paligjshme, shteti shqiptar bëhet automatikisht pronar i këtij objekti, pa domosdoshmërinë e konfiskimit apo të ndonjë veprimi tjetër.

Neni 13

Tregtimi i pasurive kulturore të luajtshme të lejuara për t’u tregtuar bëhet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, sipas rekomandimit të komisionit të specialistëve.

KREU III

PASURITË KULTURORE TË PALUAJTSHME

Neni 14

Pasuritë kulturore të paluajtshme do të quhen objektet ndërtimore me vlera historike, dokumentare, artistike, urbanistike të gjinive dhe epokave të ndryshme, në gjendje rrënoje apo të shfrytëzueshme.

Objektet që janë pjesë integrale të një strukturë të një monumentit të kulturës, lëvizja e të cilave mund të çënojë ose gjymtojnë vlerat historike, arkeologjike, shkencore, artistike sociale ose teknike të objektit, do të konsiderohen si të palevizshëm.

Neni 15

Studimi dhe restaurimi i pasurive kulturore të paluajtshme të shpallura monumente kulturore ose që janë në mbrojtje paraprahe, bëhet nga institucionet shtetërore të specializuara për këtë qëllim ose persona juridik të kualifikuar e që kanë autorizimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve .

Neni 16

Ansamblet monumentale, qytet-muze dhe monumentet me karakter kompleks shpallen pasuri kulturore dhe vihen në mbrojtje të shtetit nga Kryesia e Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 17

Monumente të kulturës si, ansambleve, kështjellave ose qyteteve-muze u përcaktohet një sipërfaqe toke ose truall përreth, zonë mbrojtëse nga institucionet për ruajtjen dhe restaurimin e monumenteve.

Për monumentet e vecanta, sipërfaqja minimale e mbrojtur duhet të jetë aq sa nevojitet për mbrojtjen dhe soditjen e tyre, kurse për ansamblet 40 m. Për qytetet-muze kufijtë përcaktohen nga Kryesia e Këshillit të Ministrave.

Neni 18

Gërmimi, restaurimi, përdorimi dhe cdo veprim tjetër në monumentet e kulturës, si dhe cdo ndryshim në truallin e vënë në mbrojtje të tyre, nuk mund të bëhet pa autorizimin e institucionit përkatës për mbrojtjen e monumenteve.

Tjetërsimi dhe zhvendosja e monumenteve kulturore bëhet me propozimin e institucionit të ngarkuar për mbrojtjen e tyre me leje të organeve të pushtetit lokal dhe me miratimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 19

Shteti ka të drejtën e shpronësimit të objekteve pasuri kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të personave juridik a fizik kur ato janë të një rëndësie të vecantë kulturore-historike ose kur këtë e dikton nevoja e mbrojtjes së tyre. Propozimi në këtë rast bëhet nga institucioni i ngarkuar për mbrojtjen e tyre dhe miratohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 20

Në monumentet e kulturës mund të kryhen punime gërmimi e restaurimi në bashkëpunim me institucionet e huaja të specializuara, në bazë të kontratave e marrëveshjeve dypalëshe, duke përjashtuar ekskluzitetin e institucioneve të huaja.

Për çdo rast institucioni kompetent që vendos për bashkëpunimin, merr miratimin për ndërhyrje në monumente nga organi më i lartë.

Neni 21

Fondet për restaurimin e monumenteve sigurohen nga buxheti i shtetit, nga fondacione të ndryshme ose prej organizatave e institucioneve të huaja shtetërore e private, nga persona privatë si dhe nga të ardhurat për nga përdorimi i monumenteve.

Fondet e siguruara nga përdorimi i monumenteve të kulturës vihen tërësisht në dispozicion të restaurimit dhe shërbimit të monumenteve.

Neni 22

Për monumentet pronë private të kategorisë së parë, shpenzimet e punimeve të restaurimit përballohen 50 për qind nga shteti. Për monumentet e kategorisë së dytë në zonat muze të qyteteve – muze përballohen në masën 25 për qind nga shteti. Në rastet kur personat privatë nuk shlyejnë detyrimet e tyre, objekti kalon në pronësi të shtetit.

Neni 23

Kur në monumentet e kulturës kryhen punime pa autorizimin e institucioneve të ngarkuara për këtë qëllim, organi i pushtetit lokal, nën juridiksionin e të cilit ndodhet monumenti i kulturës, urdhëron kthimin në gjendjen e mëparshme të monumenteve të kulturës shtetërore ose private. Urdhëri është titull ekzekutiv. Shpenzimet për kthimin e objektit në gjendjen e mëparshme përballohen nga dëmtuesi.

Në rast se shkaktohen dëme, dëmtuesi ndiqet penalisht.

Neni 24

Monumentet e paluajtshme të kulturës pronë private mund të shiten. Shteti gëzon të drejtën e parablerjes. Për çdo veprim të kësaj natyre vihen në dijeni institucionet e specializuara për mbrojtjen dhe restaurimin e monumenteve.

Neni 25

Kur gjatë punimeve të ndryshme zbulohen rrënoja të hershme, punimet e filluara ndërpriten menjëherë dhe institucionet, ndërmarrjet ose shtetas të veçantë që i zbulojnë ato, detyhen të njoftojnë menjëherë institucionin për mbrojtjen e monumenteve të kulturës, i cili është i detyruar të dërgojë përfaqësues në vend brenda 48 orëve nga data e marrjes së njoftimit.

Punimet e filluara mund të pësojnë ndryshime ose të ndërpriten përkohësisht a përfundimisht, nëse e kërkon nevoja e mbrojtjes së monumentit. Kur vendimi i institucionit të ngarkuar për mbrojtjen e monumenteve kundërshtohet, çështja vendoset përfundimisht nga organi më i lartë. Shpenzimet që kërkohen për ndryshimet si dhe ato të humbura nga pezullimi i punimeve a ndalimi i tyre përballohen nga financuesi i punimeve.

Neni 26

Institucionet që merren me studimin dhe hartimin e projekteve e të planeve rregulluese të qendrave të banuara, detyrohen ta zbatojnë këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij për mbrojtjen e monumenteve të kulturës, qendrave historike dhe qyteteve-muze.

Neni 27

Ndalohen grumbullimet masive në monumentet e kulturës, kur ato rrezikojnë ose çenojnë vlerat e tyre.

Neni 28

Monumentet e kulturës mund të përdoren me kusht që funksioni i ri të mos dëmtojë vlerat e monumentit. Për çdo rast shfrytëzimi i monumentit të kulturës lejohet vetëm pasi të jetë lidhur kontrata ndërmjet përdoruesit dhe institucionit të ngarkuar për mbrojtjen.

Neni 29

Heqja e plotë a e pjesëshme e monumentit të kulturës nga mbrojtja shtetërore është e drejtë ekskluzive e organit i cili e ka shpallur atë.

Neni 30

Çdo person juridik a fizik ose bashkëpunëtorët e tyre që tentojnë të eksportojnë a që kanë eksportuar pasuri kulturore, si dhe kanë kryer dëmtime e veprime në pasuritë kulturore të luajtshme e të paluajtshme në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kur shkeljet nuk përbëjnë vepër penale, dënohen për kundërvajtje administrative me gjobë nga 10 mijë deri më 100 mijë lekë.

Të drejtën e gjobës e kanë personat e ngarkuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Akademia e Shkencave.

Ankim kundër vendimit të dënimit me gjobë dhe ekzekutimit bëhet sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në ligjin “Për kundërvajtjet administrative”.

Shuma e arkëtuar nga vjelja e gjobave derdhet 50 për qind në buxhetin e shtetit dhe 50 për qind në favor të institucioneve që kanë në administrim pasurinë kulturore.

Neni 31

Këshilli i Ministrave ngarkohet të nxjerrë aktet për sigurimin, studimin, regjistrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e pasurive kulturore të cilat janë të detyrueshme për institucionet, ndërmarrjet, organizatat e ndryshme dhe shtetasit.

Mbrojtja e pasurive që kanë vlera kulturore e historike kombëtare bëhet nga organet kompetente, sipas listës së objekteve të përcaktuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 32

Dekreti nr. 4874, datë 23.09.1971 “Për mbrojtjen e monumenteve kulturore e historike dhe pasurive natyrore të rralla” shfuqizohet.

Neni 33

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

